



Coronavirus (COVID-19) informacion dhe shkollat – informacion për prindër

Të gjitha Qeveritë Australiane – federale, shetërore dhe territoriale – njohin rëndësinë e arsimit dhe janë të angazhuar të përkrahin studentët gjatë mësimt në periudhën e pandemisë së COVID-19.

Qeveritë e Shteteve dhe Territoreve si dhe autoritet e sektorëve kanë përgjegjësi për menaxhimin dhe marrjen e vendimeve operaionale për shkollat e tyre. Për informacion rreth shkollave në zonën tuaj se si po i përgjigjen virusit COVID-19 ju lutem kontaktoni shkollën tuaj në rastin e parë, dhe ndiqni këshillat e qeverive shtetërore ose territoriale. Lidhjet për në Faqet e internetit arsimor të qeverive shtetërore dhe territoreve janë si më poshtë:

[Australian Capital Territory](#)
[New South Wales](#)
[Northern Territory](#)
[Queensland](#)
[South Australia](#)
[Tasmania](#)
[Victoria](#)
[Western Australia](#)

Qeveritë shtetërore dhe të territoreve kanë rënë dakort që vendimet rreth mënyrës se si t’ju përgjigjen COVID-19tës në shkollat duhet të vazhdojnë të informohen nga këshillat eksperte, zyrtare , me baza kombëtare dhe shtetëore të shëndetit publik dhe të asimit.

Reduktimi i rrezikut potencial i COVID-19 në shkolla

Me **20 Prill 2020** Komiteti Kryesor Australian i Mbrojtjes së Shëndetit (Australian Health Protection Principal Committee (AHPPC) nxorri informacionin [“health advice” \(këshillime për shëndetin\)](#) në lidhje me reduktimin e rrezikut potencial të përhapjes së COVID-19 nepër shkolla. Ky udhëzim dhe këshillim praktik është përgatitur për udhëheqësit e shkollave që mirren me fëmijë, prindër, mësues dhe stafin ndihmës për të pakësuar edhe më tej rrezikun relativisht të ulët të përhapjes së coronavirusit (COVID-19) nepër shkolla gjatë pandemisë së COVID-19.

Si përmbledhje gjërat që duhet në mirren në konsideratë:

- **Për prindër:** nëse fëmija juaj është sëmurë, nuk duhet të shkojnë në shkollë. Ju duhet ta mbani fëmijën në shtëpi dhe larg të tjerëve. Mbani mend të ruani distancën fizike me prindër të tjerë dhe mësuesit kur të shkoni tek shkolla, duke përfshirë kur dërgoni dhe kur ta mirrni fëmijën/fëmijët tuaj nga shkolla.
- **Për fëmijë:** tregoi prindërit, kujdestarti apo mësuesit nëse ndihen të sëmurë.
- **Për mësuesit:** Mos vini në punë nëse jeni të sëmurë ose në një kategori personash të prekshëm.

- **Për të gjithë të rriturit:** rreziku më i madh i transmetimit në mjedisin shkollor është midis të rrituve. Është më shumë rëndësi që mësuesit dhe prindërit njësoj, të mbajnë distancën fizike midis tyre dhe njëri-tjetrit në shkollë.

Higjenë

Studentëve ju kujtohet të:

- Lani duart shpesh me sapun dhe ujë duke përfshirë para dhe pas ngrënjes dhe pasi të shkoni në tualet
- Përdorni santizuesin e duarve
- Mbuloni kollitjet dhe teshtitjet me krahun tuaj ose me një letër hundësh, jo me duart tuaja
- Vendosni letrat e hundëve në një kosh plehrash menjëherë dhe më pas lani duart.
- Përpiquini të mos prekni gojën ose fytyrën tuaj.
- Mos mbani dornën dikujt tjetër, ose mos ja jepni dorën tjetrit.
- Përpiquini të mbani më shumë hapësirë sesa normalisht mes vëhvetes dhe të tjerëve
- Shmangni rradhët
- Flisni me të tjerë (me dike) nëse ndiheni në ankth.

Marrëveshjet për klasat e larta të gjimnazeve dhe pranimet në universitetet

Me 7 Prill 2020, Ministrat shtetërorë dhe të territoreve ranë dakort që studentët e gjimnazit të vitit 12 (seniorët) do të kenë mundësi të arrijnë Çertifikatën “Senior Secondary Certificate” të shkollimit për simjet, dhe kjo çertifikatë do tua mundësojë aksesin për në universitet, arsim më të avancuar dhe punësim.

NAPLAN

Men 20 Mars 2020, Ministrat e Arsimit vendosen që testi NAPLAN nuk do të vazhdohet në vitin n 2020. NAPLAN ka qenë organizuar prej datës 12 deri me 22 May 2020.

Vendimi për të mos vazhduar me testin NAPLAN në 2020tën është marrë për t’lindihmuar mësuesit, mësuesit e shkollave si dhe stafin ndihmës që të fokusohen nw shëndetin e studentëve dhe vazhdimësinë e arsimit.

NAPLAN është një vlerësim kombëtar që teston aftësinë e studentëve në tri fusha – lexim, shkrim dhe konventat gjuhësore (drejtshkrimi, gramatika dhe pikësimi) – dhe numeration. Shkollat në të gjitha shtetet dhe territoret kanë përdorur NAPLAN në Majj çdo vit që nga viti 2008.